

UDHËZIM
Nr. 11, datë 24.10.2012

PËR PLANIFIKIMIN E FONDEVE TË PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar”, të pikës 27 të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar, të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të ndryshuar dhe pikës 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit, dhe invalidit paraplegjik e tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”,

UDHËZOJ:

1. Administratori shoqëror në bashki/komunë, në përputhje me kriteret dhe treguesit, programon kërkesat për fonde për pagesat për personat me aftësi të kufizuar e dërgon në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Programimi i fondeve për pagesat e personave me aftësi të kufizuar bëhet për çdo grup në veçanti në përputhje me nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, të ndryshuar, për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, për personat me aftësi të kufizuar fizike e mendore, si edhe për invalidët e punës.

Programi i fondeve për të verbrit bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 1956, datë 19.9.2006.

3. Fondet e nevojshme për të gjitha grupet e PAK të bashkisë/komunës përlllogariten në bazë të numrit të personave me aftësi të kufizuara për secilin grup të vlerësuar sipas vendimit të KMCAP/KMPV dhe masës së përfitimeve për secilën kategori.

Për të gjitha kategoritë mbahen parasysh pagesat e diferencuara që përfitojnë individë të veçantë për periudhën kur ndjekin arsimin e mesëm, të lartë apo pasuniniversitar, pagesave për kompensimin financiar për energjinë elektrike, telefoninë fikse apo edhe pagesën për paketën higjieno-sanitare.

Të dhënat e mësipërme plotësohen sipas Mod. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Njësitë vendore, kërkesat për fondet i programojnë sipas Mod. 1, i dorëzojnë në Zyrtat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në fund të muajit qershor të vitit në vazhdim.

5. Zyra rajonale të Shërbimit Social Shtetëror vlerësojnë kërkesat në përputhje me kriteret në fuqi dhe hartojnë nevojat për fondet e pagesës së PAK në nivel qarku dhe së bashku me Mod. 1 për secilën bashki/komunë, brenda datës 10 korrik i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, vlerëson kërkesat e ardhura nga rajonet dhe programon fondet për projektbuxhetin e vitit pasardhës në nivel kombëtar, të cilat i përcjell në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Në fund të muajit nëntor të vitit në vazhdim bashkitë/komunat, përditësojnë kërkesat për fonde sipas Mod. 1 dhe i paraqesin në Zyrtat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Zyrtat rajonale këto kërkesa i përcjellin brenda datës 10 dhjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

9. Shërbimi Social Shtetëror bën detajimin e fondeve të programuara për PAK sipas ligjit të buxhetit të vitit pasardhës për çdo bashki/komunë dhe i përcjell në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta bën transferimin e fondeve si

grante të kushtëzuara për çdo bashki/komunë për vitin pasardhës në përputhje me ligjin e buxhetit dhe udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

11. Udhëzimi nr. 2474, datë 6.12.2006 i Ministrit të Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për zbatimin e vendimit nr. 617, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera